

Kërkesa për shprehje të interesit

Emri i shkollës: **“Mustafa Bakija”**

Komuna: **Gjakovë**

Data: **09.10.2020**

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/075-CS/1.1	Zhvillim profesional 3: Trajnim për mësimdhënës – Përdorimi i programeve online në sigurimin e cilësive në mesimdhënie - Trajnim me prezencë fizike

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe **Shf “Mustafa Bakija”, Gjakovë**. Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZhSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t’i planifikojnë dhe t’i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve në formë FIZIKE në mësimdhënie efektive.

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme:

- Trajnimi Përdorimi i programeve online në sigurimin e cilësive në mesimdhënie do të vijohet nga pjesëmarrësit-mësimdhënës në formë fizike.

Kualifikimet e firmës konsulente:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme.
- Përvojë në trajnimin e mësimdhënësve dhe personelin e shkollës
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e TIK-ut;

Kriteret e vlerësimit:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha e TIK-ut (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohet në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore” të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).Firmat Konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën: **Shf “Mustafa Bakija”, Gjakovë, më së largu deri më datën; 17.10.2020** Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

Detajet kontaktuese të shkollës:

Personi kontaktues: Dhurata Nixha

Telefoni: 044-665-222

E-maili: mustafabakija.projekte@gmail.com